



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 298/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala Kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Malishevë për shkak të thyerjes të heshtjes zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Malishevë.

### Arsyetim

Me datën 09.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se me datë 08.06.2014 rreth orës 17:00 në Qendrën e Votimit Nr.3018 në shkollën fillore "Ganimete Terbeshi" në fshatin Astrazup të Malishevë është gjetur i vendosur posteri i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Haxhi Shala nga Nisma për Kosovën në afërsi më pak se 100 metra afër Qendrës së Votimit. Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e Nenit 7.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, si dhe Neni 36.1 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, pretendohet në ankesën e LVV-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë dy fotografi nga vendi i ngjarjes si dhe emrin e një dëshmitari.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### ankesa është e pabazuar

Ne bazë të provave të ofruara nuk mund të identifikohet se objekti që pretendohet në ankesë ka qenë Qendër e Votimit . PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në provë relevante, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në Nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet", lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 298/2014 më datën 11.06.2014.

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala



### **Këshillë Juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.